

VENDIM
Nr. 428, datë 10.6.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, DOKUMENTACIONIT, AFATEVE DHE
PROCEDURAVE TË DETAJUARA PËR PLOTËSIMIN, DORËZIMIN DHE
SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR ORGANIZIMIN E VULLNETARIZMIT NGA
PERSONI JURIDIK FITIMPRURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton rregullat, dokumentacionin, afatet dhe procedurat e detajuara për plotësimin, dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesës për organizimin e vullnetarizimit nga personi juridik fitimprurës.

II. DOKUMENTACIONI, AFATET DHE PROCEDURAT

1. Çdo person juridik, vendas apo i huaj, i regjistruar, që kryen veprimtari fitimprurëse dhe kërkon të ofrojë vullnetarizëm në Republikën e Shqipërisë përpara fillimit të programit të vullnetarizmit, depoziton pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (në vijim “AKPA”) kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues *online*, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, për miratimin e programit.

2. Kërkesa shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Përshkrimin e programit dhe objektivat e tij;
- b) Fushën e veprimtarisë dhe përfituesit e synuar;
- c) Planin e angazhimit të vullnetarëve, me përcaktimin e kohëzgjatjes dhe detyrave;
- ç) Masat për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- d) Planin e trajnimit dhe mbështetjes së vullnetarëve;
- dh) Mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të programit;
- e) Deklaratën se programi i propozuar është në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 24, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.

3. AKPA-ja shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e dorëzimit të tyre.

4. Në rast dokumentacioni të paplotë, AKPA-ja kërkon plotësimin e tij, brenda një afati 5-ditor.

5. AKPA-ja verifikon përputhshmërinë e programit me kushtet e përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.

6. AKPA-ja shprehet me miratimin ose refuzimin e arsyetuar të kërkesës.

7. Miratimi i programit është i vlefshëm për periudhën e përcaktuar në program.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

